

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së  
ŽALBENO VEĆE KAI**

**GSK-KPA-A-233/2013**

**Prishtinë  
16 Nëntor 2016**

Në çështjen juridike të

**S. V.**

**Pala ankuese/Paraqitësi i kërkesës**

Kundër

**J. M.**

**Pala përgjegjëse në ankesë/Pala përgjegjëse në kërkesë**

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga Beshir Islami, Kryetar i Kolegjit, Anna Bednarek dhe Krassimir Mazgalov, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/175/2012 (lënda e regjistruar në AKP me numrin. KPA47378) të datës 22 tetor 2012, pas shqyrtimit të mbajtur më 16 Nëntor 2016, mori këtë

## A K T G J Y K I M

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e S. V. kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/175/2012 të datës 22 Tetor 2012.
2. Vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/175/2012 i datës 22 tetor 2012, për aq sa i përket lëndës së regjistruar me numrin KPA 47378 vërtetohet.

### Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 16 nëntor 2007, S. (P.) V.(më tej: Pala Ankuese) ka paraqitur një kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (në tekstin e mëtuqjeshëm: AKP) duke kërkuar vërtetimin e të drejtës së pronësisë mbi një shtëpi një-katëshe dhe oborrit prapa shtëpisë si dhe ri-posedimin e ngastrës kadastrale numër 5879 që ndodhet në rrugën Svete Stefanovića 5, Fleta Poseduese Nr. 3370, zona kadastrale Prishtinë, Komuna e Prishtinës, me sipërfaqe prej 3 ari e 46 m<sup>2</sup> (në tekstin e mëtuqjeshëm: prona e kërkuar). Ai deklaroi se është pronar i pronës së kërkuar dhe se posedimin ndaj pronës e kishte humbur më 20 qershor 1999 për shkak të konfliktit të armatosur dhe se e njëjta tani është e uzurpuar në mënyrë të paligjshme nga J. M. Pala Ankuese pretendoi se ai kishte informacion se objekti po shfrytëzohej si kopsht privat për fëmijë.
2. Për ta mbështetur kërkesën e tij, Pala Ankuese dorëzoi në AKP
  - një skicë të vendit ku ndodhet prona e kërkuar
  - Fletën Poseduese Nr. 3370 të Zonës Kadastrale dhe të Komunës së Prishtinës, të datës 23 shkurt 2000, që tregon së shtëpia dhe oborri prapa shtëpisë ishin të regjistruara në emrin e tij.
3. Në raport të njoftimit, AKP-ja konfirmoi se prona e kërkuar ishte në përdorim nga J. M. dhe shfrytëzohej si kopsht privat për fëmijë. Sekretaria Ekzekutive pretendon se ia ka dorëzuar njoftimin në lidhje me kërkesën J. M. më 22 Janar 2008 por ai nuk e nënshkroi njoftimin e pjesëmarrjes në procedurë. Në të njëjtën ditë, Sekretaria Ekzekutive vendosi një shenjë në pronën e kërkuar. Më 10 shkurt 2010, AKP-ja konfirmoi se shenja dhe njoftimi në lidhje me ishte i saktë. Asnjë palë nuk ka paraqitur përgjigje në kërkesë brenda afatit prej 30 ditësh nga data e shpalljes.
4. Raporti i verifikimit të AKP-së theksoi se Fleta Poseduese ishte gjetur dhe vërtetuar në Zyrën Kadastrale. Ajo ishte e azhurnuar në Fletën Poseduese Nr. 3370 të lëshuar më 13 shkurt 2008, që e tregon Palën Ankuese si bartës i së drejtës pronësore.
5. Më 22 shkurt 2012. AKP-ja sipas detyrës zyrtare siguroi një Fletë Poseduese që shënon pronën e kërkuar të regjistruar në emër të J. M. Regjistrimi i cekur i pronës së kërkuar ishte bërë në bazë të kontratës së blerjes nr. 1292/2000 të datës 2 prill 2000.

6. Më 30 prill 2008, KKPK-ja me vendimin e vet KPCC/D/R/15/2008 vendosi se Pala Ankuese ka dëshmuar se ai është pronar i pronës së kërkuar dhe se ai ka të drejtën e posedimit të së njëjtës duke mos qenë në njohuri për faktin e vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore (KKPB).
7. AKP-ja gjeti se çështja paraprakisht ishte vendosur nga Komisioni për Kërkesa Pronësore dhe Banesore (KKPB) mbi çështjen e njëjtë ku ishte marrë vendimi HPCC/D/189/2005/C i datës 30 prill 2005, me të cilin kërkesa e Palës Ankuese (personi i njëjtë-S.V, është paraqitës i kërkesës edhe para KKPK-së) është hedhur në mungesë të juridiksionit dhe ishte referuar në gjykatën kompetente vendore.
8. Më 24 gusht 2011, Kolegji i Apelit të AKP-së të Gjykatës Supreme të Kosovës me Aktgjykimin e tij GSK-KPA-A-47/11 vendosi mbi ankesën (e paraqitur më 29 mars 2011 nga J.M.) kundër vendimit të KKPK-së KPCC/D/R/15/2008 të datës 30 prill 2008. Me këtë Aktgjykim, ankesa e J. M. është hedhur poshtë si e palejueshme duke mos vendosur për meritat e ankesës me arsyetim se pala nuk ka qenë pjesmarës në procedurën e shkallës së parë dhe nuk mund të paraqet ankesë.
9. Agjencia Kosovare e Pronës me 10 Shkurt 2012 ka kërkuar nga Gjykata Supreme që të kthehen shkresat e lëndës GSK-KPA-A-47/11 m arsyetimin se janë gjetur fakte të reja lidhur me një vendim të mëparshëm.
10. Sekretaria Ekzekutive e AKP-së kishte njoftuar Komisionin lidhur me ekzistimin e vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore (KKPB) dhe Komisioni me Vendimin e vet KPCC/RES/26/2011 të datës 7 dhjetor 2011 vendosi që vendimi i KKPK-së me numër KPCC/D/R/15/2008 i datës 30 prill 2008 të shfuqizohet sa i përket kërkesës nr. KPA47378 dhe që kërkesa t'i referohet Sekretarisë Ekzekutive për procedim të mëtejme për shkak të gabimit të procedimit që është zbuluar në një kërkesë paraprakisht të vendosur nga Komisioni.
11. Me datën 30 Janar 2012 Agjencia e kishte njoftuar Palën Ankuese në rastin konkret, se Komisioni e kishte shfuqizuar vendimin e vet dhe paraqitësi i kërkesës ishte përgjigjur në këtë njoftim me 14 Mars 2012.
12. Me vendimin KPCC/D/R/175/2012 të datës 22 tetor 2012, KKPK-ja e refuzoi kërkesën e Palës Ankuese me arsyetimin se ai nuk ka arritur që ta tregojë pronësinë apo ndonjë të drejtë tjetër pronësore mbi pronën e kërkuar menjëherë para apo gjatë konfliktit të periudhës 1998-99.
13. Në vendimin e KKPK-së (vendimi i fundit) KPCC/D/R/175/2012 i datës 22 tetor 2012 thuhet se “kërkesa refuzohet” me arsyetimin në paragrafët 38-42 ku thuhet se prona ishte humbur si rezultat i transaksionit dhe jo si pasojë e konfliktit dhe se pretendimet e palës ankuese se ka lidhur kontratë nën presion nuk janë të qëndrueshme sepse kontrata ishte lidhur në Gjykatën e Kurshumlisë në Serbi. KKPK-ja kishte zhvilluar seancë dëgjimore dhe pala ankuese edhe pse ishte ftuar nuk kishte marr pjesë. Prandaj KKPK-ja konkludoi se pala ankuese ka heq dorë nga prona vullnetarisht dhe nuk ka mundur të dëshmoi se pronën e ka humbur si pasoi e konfliktit e as që ka pas të drejta pronësore ë cilën e ka humbur si pasojë e konfliktit.

14. Më 21 qershor 2013, vendimi i KKPK-së i është dorëzuar Palës Ankuese, ndërsa më 8 maj 2013 i njëjti iu dorëzua J. M. (më tej: pala përgjegjëse në ankesë)
15. Më 15 korrik 2013, Pala Ankuese paraqiti ankesë në Gjykatën Supreme kundër vendimit të lartcekur.
16. Më 19 nëntor 2013, pala përgjegjëse u përgjigj në ankesën.

### **Pretendimet e palëve:**

#### *Pala ankuese:*

17. Pala ankuese pretendon se ai nuk i di bazat mbi të cilat KKPK-ja e ka marrë vendimin dhe se ky vendim është marrë pa praninë e tij në seancën dëgjimore të caktuar për 2 Tetor 2012, si dhe pa ndonjë shpjegim të dhënë atij. Ai shton gjithashtu se pala përgjegjëse në ankesë e ka keqpërdorur besimin e tij dhe i ka shfrytëzuar dëshmitarët për qëllimet e tij të këqija. Dëshmitarët të cilët deklarojnë se nuk ka pasur trysni kur është nënshkruar kontrata e shitjes gënjajnë, sepse dikush që nuk ka qenë i pranishëm aty nuk mund të deklarojë se nuk ka pasur nënshkrim nën trysni.
18. Ai mbajti qëndrimin se vendimi i KKPK-së është marrë me vërtetim të gabuar dhe të mangët të fakteve dhe se ai ka jetuar në pronën e kërkuar deri kur ishte detyruar të largohet më 29 korrik 1999. I ballafaquar me rrezikun ndaj jetës së tij dhe të familjes si dhe nga frika se shtëpia e tij do të shkatërrohej, pala ankuese deklaroi se ai ishte detyruar që ta nënshkruaj kontratën e blerjes e cila nuk është vërtetuar nga autoriteti kompetent, dhe se të njëjtës i është shënuar viti 1998.
19. Pala Ankuese deklaroi po ashtu se autorizimi që i ai i kishte dhënë E. M. (vëllai i palës përgjegjëse në ankesë) ishte keqpërdorur nga E. M. për përfitimet e veta duke e dëmtuar palën ankuese, pasi ai (E.M.) e ka shitur për 160.000DM, nga e cila pala ankuese nuk ka marrë asgjë. Sipas palës ankuese, autorizimi që i është dhënë vëllait të palës përgjegjëse në ankesë është bërë me qëllimin e vetëm që t'ia mundësojë të përkujdeset për pronën e kërkuar.
20. Pala ankuese po ashtu deklaroi se ai dhe familja e tij ishin sulmuar në rrugën Prishtinë-Merdare me qëllim që t'iu merren dokumentet e shtëpisë. Ai shtoi se bashkëshortja e tij ishte vrarë më 29 korrik 1999. Në fund, pala ankuese kërkoi anulimin e Vendimit të KKPK-së KPCC/D/R/175/2012 të datës 22 tetor 2012 dhe kthimin e fuqisë ligjore të vendimit KPCC/D/R/15/2008 të datës 30 prill 2009.
21. Në mbështetje të ankesës së tij, ai dorëzoi Aktgjykimin e Kolegjit të Apelit të AKP-së të Gjykatës Supreme GSK-KPA-A-47/11 i datës 22 Gusht 2011.

#### *Pala përgjegjëse në ankesë:*

22. Pala përgjegjëse në ankesë deklaroi se pretendimi i Palës Ankuese se jeta e tij dhe e familjes së tij ka qenë e rrezikuar gjatë nënshkrimit të kontratës nuk është i saktë. Nënshkrimi i kontratës (të datës 20 dhjetor 1998) është bërë edhe nga anëtarët e familjes së Palës Ankuese dhe se autorizimi (që i është dhënë E. M. – vëllait të palës përgjegjëse në ankesë) për transferimin e pronës së kërkuar është bërë nga pala ankuese në Kursumli, Serbi, ku ai nuk ka qenë nën trysni. Për më tepër, pala përgjegjëse në ankesë deklaroi se nënshkrimi i autorizimit nga pala ankuese është bërë më 2 gusht 1999 kur ai e quajti vëllain e tij E. M. shok, para se të pretendonte se më 29 korrik 1999 ai është kërcënuar nga ai (pala përgjegjëse në ankesë).
23. Sa i përket pretendimit të Palës Ankuese nëse ai ka marrë para nga shitja e pronës së kërkuar, Pala Përgjegjëse në ankesë deklaroi se Pala Ankuese në padinë e tij të datës 30 maj 2003, të paraqitur para Gjykatës Komonale të Prishtinës (C.nr. 916/03), deklaroi se për blerjen e pronës së kërkuar ai ka marrë shumën prej 80.000DM dhe jo 160.000DM sikurse është thënë në kontratën e shitjes. Prandaj, me padinë e lartcekur ai kërkoi anulimin e asaj kontrate. Pala përgjegjëse në ankesë shtoi se bazuar në këtë mund të shihet se pala ankuese e ka marrë çmimin e blerjes, por ai dëshiron që në mënyrë të paligjshme ta marrë pasurinë duke u përpjekur që të shkaktojë hutim.
24. Pala përgjegjëse në ankesë po ashtu deklaroi se pala ankuese nuk e përmend faktin se e njëjta çështje ka qenë objekt i vendimit të KKP-së HPCC/D/189/2005/c të datës 30 prill 2005, bazuar në të cilin sipas pretendimeve të tij “ai (pala përgjegjëse në ankesë) fitoi të drejtën e pronësisë mbi pronën e kërkuar”. Në bazë të vendimit të KKP-së HPCC/D/189/2005/c të datës 30 prill 2005 KKP kishte urdheruar që “*kërkesa të hedhet dhe çështja t’i referohet gjykatës kompetente lokale*”.
25. Pala përgjegjëse në ankesë pretendon se kërkesa është dashur të hidhet poshtë pasi që çështja paraqet aspekt *res judicata* dhe se KKP-ja nuk ka pasur juridiksion që të marrë vendim mbi këtë çështje për të cilën veç ishte marrë aktgjykim një herë.
26. Pala përgjegjëse shtoi se vendimi i ankimuar është i drejtë dhe si i tillë duhet të konfirmohet nga shkalla e dytë duke e refuzuar ankesën e palës ankuese si të pabazuar.
27. Për ta mbështetur pretendimin e tij, pala përgjegjëse në ankesë paraqiti autorizimin e datës 2 gusht 1999, me të cilin Pala Ankuese e ka autorizuar E.M. (vëllain e palës përgjegjëse në ankesë) për ta transferuar dhe regjistruar pronën e kërkuar; kontratën e shitjes të datës 20 dhjetor 1999 të lidhur ndërmjet palës ankuese dhe palës përgjegjëse në ankesë (të nënshkruar nga pala ankuese, bashkëshortja e tij dhe babai në njërin anë dhe pala përgjegjëse në ankesë në anën tjetër); kontratën e shitjes VR.nr.1292/2000 të lidhur më 25 korrik 2000, ndërmjet E. M. si person i autorizuar i palës ankuese dhe palës përgjegjëse në ankesë; padinë e palës ankuese të paraqitur nga pala ankuese në Gjykatën Komonale të Prishtinës (në të cilën pala ankuese pranon se ai e ka marrë pjesën e çmimit të dakorduar të blerjes në shumë prej 80.000DM dhe jo çmimin total). Pala përgjegjëse në ankesë paraqiti në AKP edhe dokumente tjera por që nuk u konsideruan si relevante në këtë çështje.

**Arsyetimi ligjor:****Pranueshmëria e ankesës:**

28. Ankesa është e pranueshme. Ajo është paraqitur brenda periudhës prej 30 ditësh sikurse parashihet me nenin 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079.
29. Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe pretendimeve ankimore sipas nenit 194 të Ligjit Nr. 03/L-006 mbi procedurën kontestimore (Gaz. Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.38/2008), Gjykata lidhur me shqyrtimin e aktgjykimit sipas detyrës zyrtare dhe për shkaqet e cekura dhe jo të cekura në ankesë gjeti se: **Ankesa është e pa bazuar**
30. Vendimi i ankimuar i KKPK-së KPCC/D/R/175/2012 i datës 22 tetor 2012, është i drejtë, i ligjshëm dhe i bazuar në vërtetim të plotë dhe të saktë të gjendjes faktike. Gjykata Supreme vëren se vendimi i ankimuar është marrë pas seancës dëgjimore të KKPK-së, në të cilën janë dëgjuar dëshmitarët e propozuar nga pala përgjegjëse në ankesë dhe janë marrë dëshmitë e tyre. Ndonëse është ftuar si duhet, pala ankuese nuk ka marrë pjesë në dëgjim. Dokumentat mbi të cilët mbështete pala përgjegjëse janë gjetur dhe verifikuar pozitivisht.
31. Gjykata Supreme konisderon se konkludimi përfundimtar i KKPK-së kur theksoi se Pala Ankuese nuk ka arritur të dëshmojë pronësinë apo ndonjë të drejtë tjetër pronësore mbi pronën e kërkuar menjëherë para apo gjatë periudhës 1998-1999, sikurse parashihet me nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, është i drejtë dhe i bazuar.
32. Kjo sepse Pala Ankuese kishte nënshkruar një Kontratë të Shitjes me palën përgjegjëse në ankesë më datën 20 dhjetor 1999, në bazë të së cilës ai ia kishte shitur pronën e kërkuar palës përgjegjëse në ankesë, dhe se humbja e pronës së kërkuar nuk ka qenë rezultat i situatës që ndodhi në vitet 1998-1999. Në paragrafin 39 të Vendimit të KKPK-së sqarohen faktet dhe rrethanat që e qojnë në konkludimin se nuk ka pasur presion ndaj palës ankuese në kohën e lidhjes së kontratëssepse e njejta ishte lidhur në Serbi dhe në praninë dhe me pëlqimin e familjarëve të tij.
33. Ndërkaq, sa i përket pretendimit të Palës Ankuese në ankesën e tij se ai nuk kishte lidhur kontratë të shitjes me vullnetin e tij të lirë, pasi që pala përgjegjëse në ankesë dhe vëllai i tij kishin ushtruar trysni dhe e kishin detyruar që ta kryejë këtë transaksion, Gjykata Supreme pranon konkludimin e KKPK-së se kontrata në fjalë ndërmjet palës ankuese dhe palës përgjegjëse në ankesë është lidhur pa ushtrim të trysnisë apo forcës. Për më tepër, e njëjta kontratë është e nënshkruar nga ai (pala ankuese), bashkëshortja dhe babai i tij.
34. Fakti se kontrata e shitjes ndërmjet Palës Ankuese dhe palës përgjegjëse në ankesë është lidhur me vullnet të lirë mbështetet gjithashtu me dëshmitë e dëshmitarëve (H. M., N. U., R. F. dhe E. M.) që janë dhënë në seancën dëgjimore të KKPK-së të mbajtur më 2 tetor 2012. Në dëshmitë e tyre, dëshmitarët deklaruan se kontrata e shitjes për pronën e kërkuar është lidhur dhe nënshkruar nga pala ankuese, bashkëshortja dhe babai i tij në njërin anë dhe nga

- pala përgjegjëse në ankesë në anën tjetër, në një procedurë normale, pa ushtrim të trybnisë apo forcës.
35. Autorizimi i datës 2 gusht 1999, i vërtetuar në Gjykatën Komonale të Kuršumlisë në Serbi, që i është dhënë palës ankuese nga E.M. (vëllai i palës përgjegjëse në ankesë) ndër tjerash për ta bërë regjistrimin dhe transferimin e pronës së kërkuar, është një argument shtesë se pala ankuese e ka shitur pronën e kërkuar në bazë të vullnetit të lirë.
  36. Gjykata vëren se lidhur me kërkesën, KKPK-ja mund të mos kishte Juridiksion pasi e njëjta ishte vendosur me vendim të formës së prerë të Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore por gjeti se janë shqyrtuar pretendimet e Palës Ankuese lidhur me të metat e kontratës të lidhur “nën presion” ashtu siç parashihen me dispozitat e nenit 4.1 Urdhëresës administrative nr. 2007/05, lidhur me kontratat e lidhura nën presion ku parasheh se “*Çfarëdo kontrate që ka për qëllim dhënie të drejtave pronësore në pronën e paluajtshme private, e cila arrihet nën presion, mund të shpallet e pavlefshme nga Komisioni, së bashku me çfarëdo shitjeje apo shitjesh pasuese të pronës*”.
  37. Prandaj Komisioni ka vepruar drejtë kur e ka refuzuar kërkesën por nuk e ka konsideruar çështjen si *res judicata* dhe nuk e hodhi kërkesën sepse ka shqyrtuar dhe nuk ka gjetur fakte se kontrata ishte e lidhur pa vullnetin e palëve nën kërcenim apo presion. Komisioni e kishte këtë tagër sipas nenit 4.1 Urdhëresës administrative nr. 2007/05. KKPK-ja konkludoi se kontrata ishte lidhur në Kurshumli dhe në prezencë të familjarëve të Palës Ankuese dhe se pjesërisht kontrata ishte zbatuar për faktin se pala ankuese kishte marrë shumën prej 80.000 DM dhe nuk kishte prova të ushtrimit të presionit.
  38. Fakti që mbështet konkludimin e cekur të KKPK-së qëndron në atë se Pala Ankuese në padinë e tij (C.nr. 916/03) për anulimin e kontratës së shitjes, të paraqitur në Gjykatën Komonale të Prishtinës më datën 30 maj 2003, deklaroi se ai e kishte marrë shumën e parave prej 80.000DM dhe pjesën e mbetur do ta paguante më vonë. Kjo padi është gjetur në Gjykatën Themelore të Prishtinës dhe janë marrë kopjet nga shkresat e lëndës ku dëshmohet se pala ankuese ka parqitur padi për anulimin e kontratës.
  39. Në fund, Gjykata Supreme është gjithashtu e pajtimit me mendimin e KKPK-së kur konkludoi se deklarata e palës përgjegjëse në ankesë përmes përfaqësuesit të tij se ai e kishte blerë pronën e kërkuar nga pala ankuese është e besueshme.
  40. Lidhur me veprimet procedurale të Komisionit përmes Rezolues për kthimin e gjendjes së mëparëshme Gjykata e vëren se një praktikë e tillë në organet administrative është e mundur dhe e lejueshme. Me rezolutën KPCC/RES/26/2011 të datës 7 dhjetor 2011 vendimi i KKPK-së KPCC/D/R/15/2008 i datës 30 prill 2008 të shfuqizohet sa i përket kërkesës nr. KPA47378 dhe që kërkesa i referohet Sekretarisë Ekzekutive për procedim të mëtejme për shkak të gabimit të procedimit që është zbuluar në një kërkesë paraprakisht të vendosur nga Komisioni. Kjo Rezolutë e KKPK-së nuk është ankimuar nga asnjëra palë në ankesë apo në përgjigje të ankesës. Përgjigjen e dhënë nga Pala ankuese pas njoftimit - për KPCC/RES/26/2011 të datës 7 dhjetor 2011 e kishte shqyrtuar KKPK-ja.
  41. Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Kolegjit të Ankesave të AKP-së është procedura dhe i referohet vendimit të KKPK-së KPCC/D/R/15/2008 të datës 30 prill 2008 dhe nuk janë

shqyrtuar meritat e ankesës e as qëndrueshmëria e vendimit të Komisionit i cili tani më është anuluar dhe nuk ekziston.

42. Përfundimisht në parim Gjykata Supreme vendos për ankesat në Vendimet e Komisionit dhe objekt shqyrtimi i Gjykatës Supreme në rastin është vendimi i ankimuar i KKPK-së KPCC/D/R/175/2012 i datës 22 tetor 2012 dhe prandaj vlerëson se ekzaminimi i provave dhe vlerësimi i tyre është bërë saktë nga KKPK-ja. Prandaj, ankesa e Palës Ankuese refuzohet si e pabazuar dhe vendimi i kundërshtuar i KKPK-së vërtetohet si i saktë dhe i bazuar në ligjin e zbatuar si duhet.
43. Duke i pasur parasysh të lartëcekurat, në përputhje me nenin 13.3 (c) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin 03/L-079 dhe nenin 195 (d) të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), është vendosur sikurse në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

### **Këshillë ligjore**

Në përputhje me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

**Beshir Islami, Kryetar i Kolegjit**

**Anna Bednarek, Gjyqtare i EULEX-it**

**Krassimir Mazgalov , Gjyqtar i EULEX-it**

**Sandra Gudaityde, Referent i EULEX-it**